



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 387/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.06.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 960 prot., datë 28.05.2019, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-21392-05-10-2019, me objekt “*Blerje materiale për nënstacionet*”, me fond limit 99.381.400 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.

Ankimues: Operatori ekonomik “Muhoplus Ltd” sh.p.k.
Rruga “Ded Gjo Luli”, Pallati 2, Ap 4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Sistemit të Transmetimit OST
Autotrada Tiranë- Durrës, Km 9 , Yrshek, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-21392-05-10-2019, me objekt “*Blerje materiale për nënstacionet*”, me fond limit 99.381.400 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 17.05.2019 operatori ekonomik “Muhoplus Ltd” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.3. Në datën 21.05.2019, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos pranuar ankesën e paraqitur.

II.4. Në datën 28.05.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të tenderit ë skualifikimin e tij dhe duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 10.06.2019, nëpërmjet shkresës me nr.3737/1 prot., datë 10.06.2019, me objekt: *“Informacion mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale për Nënstacionet”* është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Muhoplus Ltd” sh.p.k.

II.6. Në datën 19.06.2019, operatori ekonomik “Muhoplus Ltd” shpk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me nr. REF-21392-05-10-2019, me objekt *“Blerje materiale për nënstacionet”*, me fond limit 99.381.400 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “Muhoplus Ltd” shpk për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit *“Procedurë e Hapur”*, me nr. REF-21392-05-10-2019, me objekt *“Blerje materiale për nënstacionet”*, me fond limit 99.381.400 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST, Komisioni i Prokurimit Publik arsyeton:

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i cili, në nenin 94 *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”*, pika 1, parashikon se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Për sa mësipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-21392-05-10-2019, me objekt “Blerje materiale për nënstacionet”, me fond limit 99.381.400 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 960 Protokolli

Datë 28.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Enkeleda Bega	Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha